



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 2401/1 prot.

Tiranë, më 03.09.2026

Lënda: Mendim mbi projektligjin “Për bashkëpunimin administrativ në fushën e tatimeve dhe shkëmbimin e informacionit tatimor”

MINISTRISË SË FINANCAVE

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 13780 prot., datë 25.08.2026, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin “Për bashkëpunimin administrativ në fushën e tatimeve dhe shkëmbimin e informacionit tatimor”, së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Fillimisht, vërejmë se projektligji synon dhe realizon përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me Direktivën 2011/16/BE të Këshillit, datë 15.02.2011 “Për bashkëpunimin administrativ në fushën e tatimeve” e njohur ndryshe si DAC 1.

Ndërkohë, lidhur me dispozitat në të cilat parashikohen rregulla mbi përpunimin e të dhënave personale në kuadër të shkëmbimit të informacionit tatimor dhe bashkëpunimit ndërmjet administratave tatimore (*konkretisht neni 22 “Mbrojtja e të dhënave” dhe të tjerë*), vërejmë se këto nene garantojnë respektimin e parimeve dhe detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, përafrimi i këtyre parashikimeve me dispozitat përkatëse të DAC 1, të sipërpërmendur, është i plotë.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se projektligji është hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi